



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS
KOSOVO DOCTORS CHAMBER
LEKARSKA KOMORA KOSOVA

Njësia:

Unit:

Jednica:

Nr. i faqeve:

No. of pages:

Br. stranica:

Nr. Prot.:

Prot. No.:

Br. Prot.:

Data:

Datum:

Prishtinë



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

**RREGULLORE E PUNËS E KOMISIONIT
PËR SOLIDARITET DHE NDIHMË RECIPROKE
I OMK-SË**

Prishtinë, dhjetor 2022

KUVENDI I ODËS SË MJEKËVE TË KOSOVËS në mbështetje të Nenit 19, paragrafit 1 me nën-paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shëndetësor, Nenit 22, paragrafit 1 me nën-paragrafin 1.1 dhe Nenit 23 të Statutit të OMK-së, si dhe Nenit 23 paragrafi 2 të Rregullores për Procedurat Vendimmarrëse të Organeve të OMK-së, e miratuar në mbledhjen e datës 19 qershor 2018, e plotësuar dhe ndryshuar në mbledhjen e rregullt të datës 27 dhjetor 2022, Kuvendi i OMK-së miraton këtë:

RREGULLORE
E
PUNËS E KOMISIONIT
PËR SOLIDARITET DHE NDIHMË RECIPROKE

(Teksti i spastruar me plotësime dhe ndryshime të miratuara sipas Vendimit nr. 42/2022 të Kuvendit të OMK-së, datë 27 dhjetor 2022)

Neni 1

Me këtë Rregullore përcaktohet mënyra e punës së Komisionit për Solidaritet dhe Ndhimë Reciproke, i cili jep mbështetje financiare anëtarëve të OMK-së dhe familjarëve të tyre (bashkëshortit/es dhe fëmijëve), ku përcaktohet burimi i mjeteve, qëllimi dhe shuma, kushtet dhe procedurat për dhënien e ndihmës anëtarëve të Odës së Mjekëve të Kosovës dhe familjarëve të tyre (bashkëshortit/es dhe fëmijëve), që kanë të drejtë në ndihmë financiare.

Neni 2

Për dhënien e ndihmës sipas nenit 1 të kësaj Rregulloreje, Oda krijon një fond të posaçëm.

Neni 3

1. Mjetet e fondit sigurohen nga:

- 1.1. kontributet vullnetare të anëtarëve të Odës dhe personave të tjerë juridik e fizik;
- 1.2. gjobat e mbledhura nga masat disiplinore të shqiptuara;
- 1.3. mjetet financiare sipas ndarjes buxhetore në shumë prej 3.1% të shumës së përgjithshme buxhetore.

Neni 4

1. Komisioni për Solidaritet dhe Ndhimë Reciproke është njëri nga pesë (5) Komisionet e Përhershme të OMK-së:

1.1. Komisioni për solidaritet dhe ndihmë reciproke, që kujdeset për mbledhjen e fondeve dhe dhënien e ndihmës financiare ka shtatë (7) anëtarë.

1.2. Anëtarët e Komisionit propozohen nga Këshilli Drejtues i Odës dhe votohen nga Kuvendi i Odës me mandat katër (4) vjeçar.

Neni 5

Mbikëqyrja e mjeteve të fondit bëhet nga Këshilli Drejtues i Odës dhe Këshilli Mbikëqyrës i Odës së Mjekëve të Kosovës.

Neni 6

1. Mbështetja/dhënia e ndihmës financiare:

1.1. Secili anëtar i Odës i cili rregullisht paguan anëtarësinë ka të drejtë në mbështetje/ndihmë financiare.

1.2. Përveç anëtarëve të Odës nga paragrafi 6.1. i këtij neni, të drejtën për ndihmë e gëzon bashkëshorti/ja dhe fëmijët e tij/saj, në rast të shfaqjes së sëmundjes së rëndë, për shkak të së cilës nuk arrin t'i mbulojë kostot e shpenzimeve brenda dhe jashtë vendit.

Neni 7

Mbështetja/ndihma financiare e njehershme i takon anëtarit të Odës në rast të:

1.1. Humbjes së aftësisë (invaliditetit) të përcaktuar me vendim të organit kompetent, në përqindje më të madhe se 80%, për shkak të së cilës anëtari nuk mund ta kryejë në mënyrë të përhershme veprimtarinë mjekësore;

1.2. Shfaqjes së sëmundjes së rëndë për shkak të së cilës nuk arrin t'i mbulojë kostot e shpenzimeve, qoftë brenda apo jashtë vendit;

1.3. Shfaqjes së sëmundjes së rëndë së bashkëshortit/bashkëshortes, për shkak të së cilës nuk arrin t'i mbulojë kostot e shpenzimeve brenda dhe jashtë vendit;

1.4. Shfaqjes së sëmundjes së rëndë të fëmijës, për shkak të së cilës nuk arrin t'i mbulojë kostot e shpenzimeve brenda dhe jashtë vendit;

1.5. Në rast të vdekjes së anëtarit/es së OMK-së, familjes së tij/saj do t'i ndahet një shumë simbolike në vlerë prej 250,00 € (dyqind e pesëdhjetë euro), në emër të shpenzimeve të varrimi

Neni 8

1. Kriteret objektive për dhënie të ndihmës:

1.1. Komisioni gjatë shqyrtimit të kërkesave për ndihmë financiare, krahas kritereve subjektive të përcaktuara në Nenin 7 të kësaj rregulloreje, do të konstatojë nevojën për dhënie të ndihmës solidare duke u mbështetur edhe në kritere objektive.

1.2. Për secilën formë të dhënies së ndihmës sipas Nenin 7 të kësaj rregulloreje, palët duhet të aplikojnë pranë Shërbimit Profesional të OMK-së duke sjellë dokumentet e nevojshme të kërkuara sipas Nenin 11.

1.3. Komisioni për Solidaritet dhe Ndihmë Reciproke si dhe Zyra për Buxhet dhe Financa e OMK-së, rezervojnë të drejtën për të kërkuar dokumente shtesë dhe të nevojshme për të vendosur lidhur me kërkesat e palëve, dhe ekzekutimin e mjeteve të ndara në emër të ndihmës solidare.

Neni 9

Shumën për mbështetje financiare sipas Nenin 7 të kësaj Rregulloreje e përcakton Komisioni për mbështetje/ndihmë financiare, në varësi të shumës së mjeteve në fond.

Neni 10

Anëtari i OMK-së dhe familjarët sipas Nenin 1 të kësaj Rregulloreje kanë të drejtë të përfitojnë nga mbështetja/ndihma financiare e fondit të solidaritetit vetëm një (1) herë për vit kalendarik

Neni 11

1. Parashtrimi i kërkesës për ndihmë/mbështetje financiare:

1.1. Anëtari i Odës, respektivisht i autorizuari për të drejtën për ndihmë financiare, i paraqet Komisionit një kërkesë me shkrim për dhënie të mbështetjes/ndihmës financiare. Kërkesës/formularit për ndihmë financiare i bashkëngjitet dokumentacioni përkatës me të cilin vërtetohet baza për të kërkuar ndihmë (kopje të dokumenteve mjekësore, profaktura, faktura, dëshmi se pacienti është kontrolluar dhe referuar nga QKUK për trajtim jashtë QKUK-së, gjegjësisht vendimi nga kolegiumi i Klinikës, si dhe dëshmi të tjera relevante).

1.2. Kërkesa për dhënien e ndihmës financiare në rastet e specifikuar në dispozitën e nenit 7, paragrafi 1 me nënparagrafin 1.1 të kësaj Rregulloreje dorëzohet në afat prej 6 muajve pas plotësimit të kushteve të përmendura në dispozitat e lartpërmendura të Rregullores.

1.3. Kërkesa për dhënien e mbështetjes/ndihmës financiare në rastet e specifikuar në dispozitën e nenit 7, paragrafi 1 me nënparagrafët 1.2., 1.3., 1.4., të kësaj Rregulloreje, dorëzohet tek Komisioni për Mbështetje/Ndihmë financiare për vlerësimin e saj, pas identifikimit dhe diagnostikimit me sëmundjen e rëndë të anëtarit/anëtares të Odës së Mjekëve të Kosovës apo familjarit/es së tyre (bashkëshorti/ja dhe fëmijët).

1.4. Kërkesa për dhënien e mbështetjes/ndihmës financiare në rastet e specifikuar në dispozitën e nenit 7, paragrafi 1 me nënparagrafin 7.5 të kësaj Rregulloreje, dorëzohet tek Komisioni për Mbështetje/Ndihmë financiare për vlerësimin e saj, duke dorëzuar dokumentet si në vijim: Certifikatën e vdekjes së anëtarit, Certifikata e bashkësisë familjare, kopja e ID-së dhe kopja e llogarisë bankare e përfituesit (anëtarit të ngushtë të familjes) si dhe vërtetimi i lëshuar nga Komuna nga vjen anëtari i vdekur se nuk i janë mbuluar shpenzimet e varrimit.

Neni 12

1. Dhënia e ndihmës/mbështetjes financiare:

1.1. Shuma e ndihmës financiare ekzekutohet në llogarinë e anëtarit/es pas parashtrimit të kërkesës për dhënien e ndihmës financiare dhe pas aprovimit të së njëjtës me Vendim nga Komisioni.

1.2. Në rast se kërkesa është jo e plotë, Komisioni do të kërkojë nga parashtruesi që të plotësojë të njëjtën brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga marrja e njoftimit.

1.3. Nëse parashtruesi nuk e dorëzon dokumentacionin e kërkuar brenda afatit të përcaktuar, Komisioni rezervon të drejtën që ta refuzojë kërkesën me vendim.

1.4. Komisioni me kërkesë dhe arsytim objektiv të palës mund të shtyjë afatin apo të caktojë afat shtesë për plotësim të lëndës nga pala, por duke mos tejkalluar afatet e përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

Neni 13

Komisioni vendos për kërkesat e paraqitura në mbledhjet e mbajtura konform dispozitave të kësaj Rregulloreje si dhe Rregullores për Procedurat Vendimmarrëse të Organeve të OMK-së.

Neni 14

1. Vendimmarrja dhe procedura e ankimit ndaj vendimeve të Komisionit:

1.1. Pas deponimit të kërkesës së anëtarit për ndihmë financiare, Komisioni njoftohet nga zyrtari administrativ i Komisionit dhe caktohet mbledhja jo më larg se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e parashtrimit të kërkesës për ndihmë financiare.

1.2. Komisioni pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumenteve përcjellëse merr vendim për kërkesën e paraqitur nga parashtruesi, respektivisht anëtari i Odës.

1.3. Kundër vendimit të Komisionit, parashtruesi mund të paraqet ankesë në Këshillin Drejtues të Odës.

1.4. Ankesa parashtrohet brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pas pranimit të vendimit të Komisionit, ndërkaj Këshilli Drejtues i Odës është i detyruar të kthejë përgjigje jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga dita e pranimit të ankesës.

1.5. Vendimi i Këshillit Drejtues të Odës është i formës së prerë, dhe nuk mund të atakohet tutje me procedurën e ankimit.

Neni 15

1. Mbështetja administrative dhe teknike për Komisionin për Solidaritet dhe Ndihmë Reciproke nga Shërbimi Profesional i OMK-së:

1.1. Zyrtari administrativ që asiston Komisionin obligohet të mbajë një regjistër i të gjitha kërkesave të pranuar për mbështetje/ndihmë financiare dhe vendimeve të nxjerra nga Komisioni për Solidaritet dhe Ndihmë Reciproke.

1.2. Zyrtari për buxhet dhe financa i Odës, obligohet të mbajë regjistrin për mjetet e ndara.

1.3. Zyrtari ligjor i Odës asiston gjatë mbledhjeve të Komisionit duke ofruar këshilla dhe udhëzime juridike kur të tillat kërkohen.

Neni 16

Komisioni, përkatësisht Kryetari i Komisionit në emër të Komisionit është i detyruar të dorëzojë një raport mbi punën e tij në Këshillin Drejtues dhe Këshillin Mbikëqyrës, dy (2) herë në vit apo çdo gjashtë (6) muaj.

Neni 17

1. Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare:

- 1.1. Procedurat për mbarëvajtjen e punës së Komisionit për Mbështetje/Ndihmë Financiare do të realizohen sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje.
- 1.2. Për zbatimin e kësaj Rregulloreje kujdeset Kuvendi i OMK-së.
- 1.3. Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj Rregulloreje bëhen sipas të njëjtës procedurë të miratimit.

Neni 18

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit të saj nga Kuvendi i OMK-së dhe nënshkrimit nga Kryetari i OMK-së.

Prishtinë, 27 dhjetor 2022

Kryetari i OMK-së

Dr. Pleurat Sejdiu, Mr. Sci

